

**15** Depozitat arrijnë  
vlerën 3.36 miliardë euro

**11** Plaçkitjet e bankave  
komerciale, merren  
masa parandaluese

# IBANK

Mars 2019 | Nr. 20 - Gratis

**Edukimi financiar  
sjellë përfitime të  
shumëfishta**

FAQE 06



# ZHVILLIMI PËRMES EDUKIMIT FINANCIAR

FAQE 03



# SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS PËRZGJEDH SHKOLLAT QË DO TË PËRFITONJË NGA PROGRAMI I JAVËS NDËRKOMBËTARE TË PARASË 2019- “MËSO, KURSE, FITO”

Shoqata e Bankave të Kosovës në kuadër të aktiviteteve të saj edukativo-financiare do të organizojë programin e Javës Ndërkombëtare të Parasë 2019, me moto “MËSO, KURSE, FITO”, ku nga data 25 mars do të bëjë shpërndarjen e pakove me materiale edukative për fëmijë.

Nga data 25 mars, Shoqata e Bankave të Kosovës do të bëjë shpërndarjen e pakove me materiale edukative për fëmijë. Në tetë (8) komuna të Kosovës, duke përfshirë Prishtinën, Ferizajn, Gjakovën, Mitrovicën, Pejë, Istogun, Podujevën dhe Vushtrinë. Në këto tetë (8) komuna janë përzgjedhur shkollat fillore ku do të ligjërohet në 16 klasë, për nxënës të klasës së katërt dhe pestë, me një pjesëmarrje prej 1440 nxënësve.

Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, z. Petrit Balija, tha se “Me këto aktivitete, Shoqata e Bankave të Kosovës synon që të angazhojë fëmijët dhe të rinjtë për të mësuar më shumë për financat, duke përfshirë këtu kursimet, menaxhimin e parasë, menaxhimin e financave personale etj. Këto aktivitete

mbështeten dhe financohen nga bankat komerciale të Kosovës të cilat kanë për qëllim që të fuqizojnë shoqërinë përmes edukimit financiar.”

Gjatë kësaj jave fëmijët do të kenë aktivitete të ndryshme, si plotësimin e librit të kursimeve, punime dore dhe vizatime në lidhje me paratë dhe kursimet. Shoqata e Bankave të Kosovës ka përgatitur udhëzuesit për mësuesit në mënyrë që ta zbatojnë pakon edukative. Nxënësit do të punojnë në librin e kursimeve, përmes të cilave kanë për të shprehur idetë e tyre rreth rëndësisë së menaxhimit të parave, planifikimit e tyre për kursimet si dhe menaxhimin e parasë për të ardhmen. Pjesë e paketës së edukimit është edhe një donacion i materialeve shpenzuese për fëmijët, si fletore, lapsa dhe goma të cilat mund të shfrytëzohen edhe

për nevoja të përgjithshme arsimore.

Në kuadër të edukimit financiar dhe fushës së kursimeve, më qëllim të ndërgjegjësimit të fëmijëve, nxënësve dhe të rinjve në përgjithësi, çdo vit, në 169 vende të botës organizohet fushata e njohur “Java Ndërkombëtare e Parasë”. Kjo javë këtë vit do të mbahet me datat 25 deri me 31 mars, me moton “Mëso, Kurse, Fito”. Qëllimi kryesor i shënimit të kësaj jave është fuqizimi i gjeneratave të reja dhe të rrisë vetëdijen në lidhje me financat personale.

Organizata “Të rinjtë, fëmijët dhe financat ndërkombëtare” (Child And Youth Finance International) është bartëse e këtyre aktiviteteve në gjithë botën, ku anëtare në këtë organizatë është Shoqata e Bankave të Kosovës tash e disa vite.



# Zhvillimi përmes edukimit financiar

Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik(OECD) për ekonomitë në zhvillim, ku përfshihet edhe Kosova, konsumatorët e arsimuar financiarisht mund të ndihmojnë që sektori financiar të jap një kontribut efektiv në rritjen e vërtetë ekonomike dhe në uljen e varfërisë

**P**as krizës ekonomike financiare globale në vitin 2008, krahas vendeve tjera, nevoja për avancimin e edukimit financiar ka marrë vëmendje më të madhe edhe në Kosovë. Kjo për faktin se edukimi financiar u ofron qytetarëve njohuri për të marrë vendime të duhura ekonomike e financiare, qoftë si individ apo biznes, për menaxhim sa më të mirë të financave personale dhe t'i aftësoj të njëjtit për t'i vlerësuar

vendimet e marra në raport me produktet dhe shërbimet financiare, të ofruar nga sektori financiar.

Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik(OECD) për ekonomitë në zhvillim, ku përfshihet edhe Kosova, konsumatorët e arsimuar financiarisht mund të ndihmojnë që sektori financiar të jap një kontribut efektiv në rritjen e vërtetë ekonomike dhe uljen e varfërisë.

# “

“Synimi kryesor është që ky vetëdijesim të fillojë nga moshat e reja në mënyre që më vonë njohuritë e fituara të aplikohen në menaxhimin e financave personale. Sektori Bankar realizon një gamë të gjerë aktiviteteve në këtë drejtim, individualisht si institucione bankare, por edhe përmes Shoqatës së Bankave të Kosovës”, thotë Fehmi Mehmeti



## EFEKTE POZITIVE TË EDUKIMIT FINANCIAR SIPAS OECD-SË

Sipas OECD-së, njohuritë financiare janë vendimtare për ekonominë më të zhvilluara, për të ndihmuar konsumatorët që të kursejnë mjaftueshëm sa duhet për të siguruar të ardhura adekuate deri në pension, për të shmangur nivele të larta borxhi që mund të çojnë në falimentim dhe bankrotim. Individët, sipas OECD-së, nuk do të jenë në gjendje të zgjedhin kursimet, ose investimet e duhura për veten e tyre dhe mund të jenë në rrezik mashtrimi, nëse nuk janë të shkolluar financiarisht.

“Por, nëse individët bëhen të arsimuar financiarisht, ata do të kenë gjasa më shumë të shpëtojnë dhe t’i sfidojnë ofruesit e shërbimeve financiare për të zhvilluar produkte që me të vërtetë u përgjigjen nevojave të tyre, dhe kjo duhet të ketë efekte pozitive në të dy nivelet e investimeve dhe në rritjen ekonomike”.

Në Bankën Qendrore të Kosovës thonë se gjatë dekadës së fundit, rëndësia e edukimit financiar është rritur shumë shpejt në përgjithësi, e në bankingun qendror në

veçanti, sepse kompleksiteti i sektorit financiar u paraqit si sfidë në mbarë botën.

“Publiku ka nevojë që të këto njohuri rreth këtyre produkteve dhe shërbimeve t’i mësojë dhe gjithashtu të informohet për rolin e BQK-së në ekonominë e Kosovës, për mbrojtjen e të drejtave të tyre në raport me institucionet financiare dhe shumë informata tjera të cilat mund të ofrohen përmes kësaj fushe”, shprehet guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti.

## EDUKIMI FINANCIAR NUK ËSHTË PJESË E KURRIKULËS SHKOLLORE

Sipas guvernatorit Mehmeti edukimi financiar nuk mësohet në institucionet tona arsimore, d.m.th. nuk është pjesë e kurrikulës shkollore dhe rrjedhimisht nevoja është mjaft e madhe për të ofruar sa më shumë informata, duke i adaptuar komunikimet e ekspertëve ekonomikë në atë mënyrë që të kuptojnë të gjithë qytetarët.

Ai ka shtuar se nëse shikohet nga perspektiva e Bankës Qendrore, edukimi financiar ka rëndësi të madhe financiare, sepse, siç thotë ai, sa më shumë njohuri financiare të kenë qytetarët, posaçërisht sa i përket shfrytëzi-

mit të shërbimeve dhe produkteve financiare, aq më shumë do të ndihmohet ekonomia, e gjithashtu do të ndihmohet edhe Banka Qendrore me qëllim të promovimit të mirëqenies financiare dhe ekonomike në shoqërinë kosovare. “Në të njëjtën kohë, njohuritë financiare të qytetarëve do të ndikojnë edhe në sektorin bankar, në përmirësimin e shërbimeve dhe në avancimin e sistemit financiar në përgjithësi”.

## EDUKIMI FINANCIAR I GJENERATAVE TË REJA

Drejtuesit e Bankës Qendrore të Kosovës thonë se edukimi financiar është i rëndësishëm jo vetëm për financat personale, por edhe për ekonominë e vendit në tërësi, pasi, sipas tyre, e bën shpërndarjen e burimeve më eficiente në funksion të rritjes ekonomike dhe reduktimit të varfërisë. Përveç Bankës Qendrore, edhe bankat komerciale viteve të fundit kanë kontribuar shumë për komunitetin në mënyrë që të ngritët vetëdijesimi për edukimin financiar. “Synimi kryesor është që ky vetëdijesim të fillojë nga moshat e reja në mënyre që më vonë njohuritë e fituara të aplikohen në menaxhimin e financave personale.





# Mehmeti: Edukimi financiar sjellë përfitime të shumëfishta

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka theksuar se edukimi Financiar është i rëndësishëm jo vetëm për financat personale, por edhe për ekonominë e Kosovës në përgjithësi, që sipas tij, e bën shpërndarjen e burimeve më eficiente në funksion të rritjes ekonomike dhe reduktimit të varfërisë

Edukimi Financiar është i rëndësishëm jo vetëm për financat personale, por edhe për ekonominë e Kosovës në përgjithësi, pasi e bën shpërndarjen e burimeve eficiente në funksion të rritjes ekonomike dhe reduktimit të varfërisë. Kështu është shprehur në një intervistë guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti. Ndër të tjera ai ka shtuar se bankat komerciale viteve të fundit kanë kontribuar shumë për komunitetin, në mënyrë që të ngrihet vetëdijesimi për edukimin financiar. Sipas tij, synimi kryesor është që ky vetëdijesimi të fillojë

nga moshat e reja, në mënyrë që më vonë njohuritë e fituara të aplikohen në menaxhimin e financave personale.

Mehmeti ka theksuar se sektori bankar realizon një gamë të gjerë aktivitetesh në këtë drejtim, edhe individualisht si institucione bankare, por edhe përmes Shoqatës së Bankave të Kosovës. “Aktivitetet kanë shtrirje në gjithë vendin, nëpër komuna të ndryshme, ku edhe veprojnë institucionet bankare me degët dhe filialet e tyre. Tema kryesore që këto aktivitete e kanë përcjellë ndër vite është kursimi

# Depozitat për kokë banori në rajon

	<b>Shteti</b>	<b>depozitat</b>	<b>nr. i banorëve</b>	<b>depozitat për kokë banori</b>
	<b>Kosova</b>	3.47 mld.€	1.8 milion	1900 €
	<b>Maqed.e V.</b>	6.5 mld. €	2.1 milionë	3100 €
	<b>Shqipëria</b>	9.5 mld. €	2.8 milionë	3300 €
	<b>Mali i Zi</b>	3.4 mld. €	600 mijë	5700 €
	<b>Bosnja e H.</b>	17.4 mld. €	3.5 milionë	5000 €
	<b>Serbia</b>	20.7 mld. €	7 milionë	3000 €

# 3.347.000.000€

kanë arritur depozitat në sektorin bankar të Kosovës.



dhe menaxhimi më i mire i financave personale. Aktiviteti më gjithëpërfshirës i sektorit është “Java Ndërkombëtare e Parasë”, e cila realizohet përmes Shoqatës së Bankave të Kosovës, me mbështetjen e Bankave Komerçiale. Deri më tani, përmes pjesëmarrjes së tyre në ligjërata dhe seminare por edhe ushtrime praktike në edukim financiar kanë përfituar mijëra të rinjë”, ka thënë ai. Duke folur edhe për edukimin financiar të bizneseve, guvernatori Mehmeti ka thënë se sa më të edukuara financiarisht të jenë bizneset kosovare, aq më stabile dhe të suksesshme do të jenë në vendimmarrjen e tyre.

#### **Sa është i nevojshëm edukimi financiar për qytetarët e Kosovës, sidomos për gjeneratat e reja?**

**Mehmeti:** Gjatë dekadës së fundit, rëndësia e edukimit financiar është rritur shumë shpejt në përgjithësi, e në bankingun qendror në veçanti, sepse kompleksiteti i sektorit financiar u paraqit si sfidë në mbarë botën. Pas krizës ekonomike financiare në vitin 2008, nevoja për ta avancuar temën e edukimit financiar mori vëmendje gjithnjë e më të madhe. Sektori financiar në Kosovë ofron shumëllojshmëri të produkteve dhe shërbimeve financiare. Publiku ka nevojë që të keto njohuri rreth këtyre produkteve dhe shërbimeve, t'i mësojë dhe të informohet për rolin e BQK-së në ekonominë e Kosovës, për mbrojtjen e të drejtave të tyre në raport me institucionet financiare dhe shumë informata tjera të cilat mund të ofrohen përmes kësaj fushe.

#### **ÇKA ËSHTË EDUKIMI FINANCIAR?:**

Edukimi Financiar u ofron qytetarëve njohuri për të marrë vendime të duhura ekonomike e financiare, qoftë si individ apo si bi-



# 70%

të depozitave në sektorin bankar janë të ekonomive familjare.

znes, për menaxhim sa më të mirë të financave personale dhe t'i aftësojë për t'i vlerësuar vendimet e marra në raport me produktet dhe shërbimet financiare, të ofruara nga sektori financiar. Edukimi Financiar nuk mësohet në institucionet tona arsimore, d.m.th nuk është pjesë e kurrikulës shkollore dhe rrjedhimisht nevoja është mjaft e madhe për të ofruar sa më shumë informata, duke i adaptuar komunikimet e ekspertëve ekonomikë në atë mënyrë që të kuptojnë të gjithë qytetarët.

Cilat janë përfitimet individuale, por edhe përfitimet për ekonominë e Kosovës nëse i jepet rëndësi edukimit financiar?

**Mehmeti:** Nëse e shikojmë nga perspektiva e Bankës Qendrore, Edukimi financiar ka rëndësi të madhe financiare, sepse sa më shumë njohuri financiare të kenë qytetarët, posaçërisht sa i përket shfrytëzimit të shërbimeve dhe produkteve financiare, aq më shumë do të ndihmohet ekonomia, e gjithash-tu do të ndihmohet edhe Banka Qendrore më qëllim të promovimit të mirëqenies financiare dhe ekonomike në shoqërinë kosovare. Në të njëjtën kohë, njohuritë financiare të qytetarëve do të ndikojnë edhe në sektorin bankar, në përmirësimin e shërbimeve dhe në avancimin e sistemit financiar në përgjithësi.

#### **Sa kanë kulturë kursimi qytetarët e Kosovës?**

**Mehmeti:** Edukimi financiar nuk është pjesë e kurrikulës shkollore dhe BQK-ja nuk posedon statistika rreth nivelit të njohurive financiare në Kosovë, d.m.th. deri më tani nuk është bërë ndonjë analizë, si p.sh. përmes ndonjë ankete për të parë nivelin e njohurive financiare të qytetarëve të Kosovës. Për këtë qëllim, BQK-ja në vazhdimësi angazhohet përmes aktiviteteve të ndryshme, duke filluar nga shkollat fillore e tutje, që të rrisë nivelin e vetëdijes dhe rëndësisë së



# 261.000.000€



## është rritja e depozitave në sektorin bankar për një vit.

kursimeve. Megjithatë, niveli i depozitave në vend ka rritje të përvitshme, të cilat në fund të vitit 2018 janë në shumë prej 3.3 miliardë euro, prej të cilave 2.3 miliardë euro depozita të ekonomive familjare, e që tregon se qytetaret tanë kanë kulturë të të kursyerit.

### **RRITJA E DEPOZITAVE BANKARE**

**Sa kanë arritur depozitat e qytetarëve në sektorin bankar?**

**Mehmeti:** Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar vazhdojnë të jenë depozitat, vlera e të cilave gjatë vitit 2018 arriti në 3.3 miliardë euro, të cilat krahasuar me vitin e kaluar kanë shënuar rritje 6.9%.

Rritja e depozitave vit pas viti tregon për besimin e lartë që sektori bankar gëzon te qytetarët e vendit. Bazuar në të dhënat e fundit në dispozicion, në janar të vitit 2019, vlera e depozitave ka arritur në 3 miliardë e 347 milionë euro. Nga kjo shumë rreth 70% e totalit të depozitave janë depozita të ekonomive familjare, kurse pjesa tjetër janë depozita të ndërmarrjeve. Në krahasim me janarin e vitit të kaluar 2018, vlera e depozitave është rritur për 261 milionë euro më shumë, ku në janar të vitit 2018, vlera e depozitave ishte 3 miliardë e 86 milionë euro.

**Sa është shuma e depozitave për kokë banori në Kosovë dhe sa janë në vendet e rajonit?**

**Mehmeti:** Sektorin bankar në Kosovë është sektor relativisht i ri, i cili në vazhdimësi ka shënuar rritje dhe çdo ditë e me tepër është duke e rritur rolin e tij në përkrahjen e bizneseve dhe zhvillimit ekonomik të vendit, në përgjithësi. Edhe depozitat e qytetareve në sektorin bankar kanë pasur rritje vit pas viti. Vlera e depozitave në Kosovë vitin e kaluar ishte 3.3 miliardë euro, apo 1.900 euro për kokë banori. Në shtetet tjera të rajonit vlera

e depozitave është si më poshtë: Në Maqedoninë e Veriut, e cila ka 2.1 milionë banorë, vlera e depozitave ishte 6.5 miliardë euro. Sa i përket shumës së depozitave për kokë banori në këtë vend, ajo ka arritur në vlerën 3.100 euro. Në Shqipëri, ku numri i banorëve është 2.8 milionë, vlera e depozitave ka arritur në 9.5 miliardë euro, apo 3.300 euro për kokë banori. Në Mal të Zi, ku numri i popullsisë është mbi 600 mijë banorë, depozita për kokë banori arrin në 5.700 euro, kurse vlera e tërësishme e depozitave ishte 3.4 miliardë euro. Në Bosnjë dhe Hercegovinë që ka 3.5 milionë banorë, vitin e kaluar vlera e depozitave arriti në 17.4 miliardë euro apo 5 mijë euro për kokë banori.

Në Serbi, ku numri i popullsisë është 7 milionë, vitin e kaluar vlera e depozitave ishte mbi 20.7 miliardë euro, ndërsa vlera për një kokë banoni arrin në 3 mijë euro.

**Sa i kushtojnë rëndësi bankat komerciale, por edhe BQK-ja edukimit financiar?**

**Mehmeti:** Stabiliteti financiar është objektiv primar i Bankës Qendrore, rrjedhimisht një shkallë më e lartë e edukimit financiar mund të kontribuojë dhe ndikojë në ruajtjen e këtij stabiliteti. Që nga themelimi i saj në vitin 1999, BQK-ja ka ndërmarrë aktivitete dhe iniciativa për edukim financiar, duke organizuar ligjërata në universitete, takime punuese me gazetarë, aktivitete me nxënës etj. Përveç këtyre aktiviteteve të vazhdueshme, gjatë vitit 2013, BQK-ja e ka themeluar funksionin e Edukimit financiar në kuadër të Departamentit për Marrëdhënie me Jashtë, i cili ka zhvilluar një program të edukimit financiar në bazë të të cilit edhe realizon aktivitete, projekte e ngjarje të ndryshme. BQK-ja në vazhdimësi investon, si në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, ashtu edhe financiare, në mënyrë që të kemi rezultate të cilat do të jenë

afatgjata, sepse edukimi financiar është proces afatgjatë.

Sa u përket bankave komerciale, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës bashkëpunon për së afërmi me Shoqatën e Bankave dhe institucionet tjera rreth aktiviteteve, ngjarjeve dhe materialeve të edukimit financiar. Rrjedhimisht, deri më tani kanë organizuar një numër të aktiviteteve të përbashkëta rreth edukimit financiar, por gjithsesi që ka edhe aktivitete të veçanta të organizuara nga bankat edhe në mënyrë individuale, në vazhdimësi.

**Sa investojnë bankat në edukim financiar të klientëve?**

**Mehmeti:** Edukimi Financiar është i rëndësishëm jo vetëm për financat personale, por edhe për ekonominë e vendit në tërësi, pasi e bën shpërndarjen e burimeve më eficiente në funksion të rritjes ekonomike dhe reduktimit të varfërisë. Bankat komerciale viteve të fundit kanë kontribuar shumë për komunitetin në mënyrë që të ngritët vetëdijesimi për edukimin financiar. Synimi kryesor është që ky vetëdijesim të fillojë nga moshat e reja në mënyrë që më vonë njohuritë e fituara të aplikohen në menaxhimin e financave personale. Sektorin Bankar realizon një gamë të gjerë aktiviteteve në këtë drejtim, individualisht si institucione bankare, por edhe përmes Shoqatës së Bankave të Kosovës. Aktivitetet kanë një shtrirje në gjithë vendin, nëpër komuna të ndryshme ku edhe veprojnë institucionet bankare me degë dhe filialet e tyre. Tema kryesore që i ka përcjellë ndër vite këto aktivitete është kursimi dhe menaxhimi më i mirë i financave personale. Aktiviteti me gjithëpërfshirës i sektorit është “Java Ndërkombëtare e Parasë”, e cila realizohet përmes Shoqatës së Bankave të Kosovës, me mbështetjen



e Bankave Komeriale. Deri më tani kanë përfituar mijëra të rinjë, përmes pjesëmarrjes së tyre në ligjërata dhe seminare, por edhe ushtrime praktike në edukim financiar. Objektivi i përbashkët i sektorit financiar ka bërë që shumë nga aktivitetet të bashkëorganizohen në mes të Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, kështu duke arritur një efekt pozitiv më të madh. Edukimi financiar mbetet një prej shtyllave kryesore të zhvillimit të sektorit financiar dhe ekonomisë së vendit duke e rritur mirëqenien socio-ekonomike të popullatës së Kosovës.

### **SEKTORI BANKAR, NDËR MË TË SUKSESSHMIT NË KOSOVË**

**Kosovarët kanë pasur përvojë të keqe me depozita bankare në sistemin e kaluar (para luftës), të cilëve u kanë humbur shumë kursime. A kanë arritur bankat t'i bindin kosovarët se kursimet e tyre janë të sigurta?**

**Mehmeti:** Sektori financiar në përgjithësi konsiderohet të jetë një prej sektorëve më të suksesshëm në Kosovë. Kur flasim vetëm për sektorin bankar, natyrisht duhet të cekim se është një prej sektorëve më stabil dhe të suksesshëm, i cili po kontribuon në zhvillimin ekonomik të vendit. Trendi

rritës i depozitave të qytetarëve të Kosovës është faktor që tregon se qytetarët kanë besueshmëri të lartë në këtë sektor.

### **A ka rritje apo rënie të ankesave të konsumatorëve ndaj bankave komerciale dhe a ka arritur BQK-ja t'i zgjidhë ato?**

**Mehmeti:** Numri i ankesave në vitin 2016 ishte 535. Nga ky numër, 335 ishin për bankat komerciale, Institucionet mikrofinanciare (IMF), Institucionet Financiare Jobankare (IFJB), Fondet Pensionale, dhe 283 ankesa ishin për kompanitë e sigurimeve. Nga ky numër 40.60% e ankesave janë zgjidhur në favor të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare, kurse 59.40% u zgjidhën në favor të institucioneve financiare. Në vitin 2017, numri i ankesave u rrit në 602, prej të cilave 335 ankesa ishin për bankat komerciale, IMF, IFJB, Fonde Pensionale, dhe 267 për kompanitë e sigurimeve. Nga numri i përgjithshëm prej 602 ankesave, 37.15% u zgjidhën në favor të favor të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare, përderisa 62.85% u zgjidhën në favor të institucioneve financiare. Vitin e kaluar ka pasur rritje të numrit të ankesave, të cilat arritën në 927, prej të cilave 532 ankesa ishin për bankat komerciale, IMF, IFJB, Fonde Pensionale, ndërsa 395 ankesa u bënë për kompanitë e sigurimeve. Përqindja e ankesave të zgjidhura në favor

të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare gjatë vitit 2018 ishte 42.83%, kurse 57.17% të ankesave u zgjidhën në favor të institucioneve financiare.

### **RËNDËSIA E EDUKIMIT FINANCIAR PËR BIZNESET**

**Sa është i rëndësishëm edukimi financiar për bizneset kosovare?**

**Mehmeti:** Avancimet në fushën e teknologjisë, ndikimi i globalizmit dhe akterët e shtuar në tregje, sot kanë ndikuar që edhe në tregjet kosovare konkurrenca të jetë e nivelit mjaft të lartë. Zhvillimi i një mjedisi të sigurt dhe të drejtë për ofrimin e shërbimeve financiare është një nga qëllimet kryesore strategjike të Bankës Qendrore të Kosovës. Po ashtu, ndërtimi i një tregu financiar të sigurt dhe të ndershëm është një punë afatgjate që kërkon një angazhim të vazhdueshëm të institucioneve financiare, Bankës Qendrore dhe institucioneve tjera qeveritare. E gjithë kjo do jete në funksion të zhvillimit të ekonomisë. Rrjedhimisht, sa më të edukuara financiarisht të jenë bizneset kosovare, aq më stabile dhe të suksesshme do të jenë në vendimmarrjen e tyre. Edukimi financiar rrit aftësi për të marrë vendime të shëndosha financiare duke qenë të informuar drejt dhe me kohë për të mbrojtur të drejtat, por edhe duke njohur përgjegjësit e tyre.



# Plaçkitjet e bankave komerciale, merren masa parandaluese

Për shkak të rritjes së rasteve të plaçkitjeve të bankave komerciale, me iniciativë të Bankës Qendrore të Kosovës, në fillim të shkurtit të këtij viti është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me ministrin e Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, drejtorin e Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj dhe drejtorin ekzekutiv të Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, shprehet i shqetësuar për rritjen e rasteve të plaçkitjes së bankave komerciale në Kosovë, me ç'rast, sipas tij, ata bashkë me institucionet e sigurisë janë duke i ndërmarrë masat e nevojshme për t'i parandaluar rastet e tilla. Sipas tij, gjatë vitit 2018 në Kosovë kanë ndodhur 18 raste të plaçkitjes së bankave, derisa në vitin 2017 kishin qenë 8 raste, dhe në vitin 6 raste 2016. "BQK është duke e trajtuar me prioritet dhe rëndësi të lartë këtë dukuri, duke ndërmarrë veprimet e nevojshme në kuadër të përgjegjësisë së saj. BQK ka realizuar një takim me organet e sigurisë, me të cilët u diskutua për shqetësimet rreth dukurisë së plaçkitjes së bankave në Kosovë. Të gjithë përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse në këtë takim shprehën gatishmërinë për ndërmarrjen e masave të nevojshme, me qëllim të rritjes së nivelit të sigurisë dhe u pajtuan rreth masave konkrete për të rritur bashkëpunimin ndërinstitucional në këtë fushë", ka thënë Mehmeti.

## DEPOZITAT E KLIENTËVE, TË SIGURTA

Sipas tij, bazuar në Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut Operacional, bankat informojnë BQK-në lidhur me këto ngjarje dhe organet tjera përkatëse që janë përgjegjëse. "Çdo dëmtim financiar që ndodh me rastin e vjedhjeve të bankave kompensohet nga vet banka dhe asnjëherë nga klientët apo BQK-ja. Për më shumë, në funksion të mbulimit të dëmeve financiare

bankat sigurojnë parandë e gatshme", ka potencuar kreu i BQK-së. Ai ka bërë të ditur se në dhjetor të vitit të kaluar, BQK-ja ka marrë iniciativën për të filluar diskutimet lidhur me këtë çështje së bashku me ministrin e Punëve të Brendshme Ekrem Mustafa, drejtorin e Departamentit të Hetimeve të Policisë së Kosovës Riza Shillova, anëtarin e Bordit të Shoqatës së Bankave Orcun Ozdemir dhe drejtorin ekzekutiv të Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija.

"Teme kryesore e diskutimit ishte shqetësimi rreth dukurisë së plaçkitjes së bankave në Kosovë. Me të gjithë përfaqësuesit e lartpërmendur u pajtuam për qenë në gatishmëri për të ndërmarrë masat e nevojshme, me qëllim të rritjes së nivelit të sigurisë në sektorin bankar dhe për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional për të adresuar këto sfida", ka theksuar ai. Sipas Mehmetit, si rezultat i kësaj iniciative, në fillim të shkurtit të këtij viti u nënshkrua marrëveshje e bashkëpunimit me ministrin e Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, drejtorin e Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj dhe drejtorin Ekzekutiv të Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, dhe Bankës Qendrore. "Marrëveshja ka për qëllim avancimin e bashkëpunimit për ngritjen e nivelit të sigurisë në sektorin bankar në mënyrë që bankat, personeli i tyre dhe qytetarët të kenë një ambient sa më të sigurt për zhvillimin e aktivitetit të tyre".

## PLANI OPERATIV I POLICISË SË KOSOVËS

Në anën tjetër, për shkak të rritjes së

numrit të rasteve të plaçkitjes së bankave, Ministria e Punëve të Brendshme ka marrë vendim që tani e tutje punëtorët që i ruajnë bankat të pajisen me armë, kurse patrullat policore të pajisen me armë të gjata. Lajmin për këtë e ka dhënë ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ku ka shpjeguar se tani MPB dhe Policia kanë bërë një plan operativ, përmes të cilit po synohet që të ndalet kjo dukuri negative që po ndodhë në Kosovë. "Ne e kemi bërë edhe planin operativ duke mos u përzier në planin e policisë, por kemi marrë masa që patrullat policore të bartin edhe armë të gjata, sepse është fakt shqetësues që bandat po përdorin edhe bomba", tha Mustafa. Ndërkaq, sipas një njoftimi nga Shoqata e Bankave të Kosovës, marrëveshja e nënshkruar në mes të Ministrisë së Brendshme, BQK-së, dhe Shoqatës së Bankave të Kosovës, ishte rezultat i takimeve të mëhershme të zhvilluara me përfaqësues të këtyre institucioneve, në të cilat u diskutua për shqetësimet rreth dukurisë së plaçkitjes së institucioneve financiare në Kosovë. "Marrëveshja ka për qëllim avancimin e bashkëpunimit për ngritjen e nivelit të sigurisë në sektorin bankar në mënyrë që bankat, personeli i tyre dhe qytetarët të kenë një ambient sa më të sigurt për zhvillimin e aktivitetit të tyre", thuhet mes tjerash në njoftimin e Shoqatës së Bankave të Kosovës.



# Kosova me sistem financiar modern

**B**anka Qendrore e Republikës së Kosovës, në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 20 vjetorit të themelimit ka mbajtur diskutim për nder të Ditës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Konsumatorit me temë Roli i BQK-së në fushën e mbrojtjes së Konsumatorit. Me këtë rast, guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti është shprehur se falë marrjes së masave nga BQK-ja gjatë këtyre 20 viteve, kanë ndikuar që vendi të ketë një sistem financiar modern dhe të shëndoshë, i cili me shumë sukses po e realizon rolin e tij të ndërmjetësimit financiar në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë së vendit.

Sipas guvernatorit Mehmeti, vend të rëndësishëm kanë zënë aktivitetet të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorit, duke u fokusuar në dy shtyllat kryesore të kësaj iniciative: shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve dhe

edukimi financiar. “Përderisa në vitet e para të funksionimit të sistemit financiar, fokusi ishte në krijimin e kushteve për sigurimin e shërbimeve financiare bazike për ekonominë e vendit, tani kemi arritur në një fazë ku çdo ditë e më tepër po i kushtojmë rëndësi më të madhe edhe cilësisë së këtyre shërbimeve, ku pa dyshim se vend shumë të rëndësishëm zënë aktivitetet të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorit të shërbimeve financiare”, ka pohuar Mehmeti.

## RRITEN ANKESAT E KLIENTËVE

Përmes shqyrtimit të ankesave, sipas guvernatorit Mehmeti, BQK-ja synon sigurimin e zbatimit të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale ndërmjet institucioneve financiare dhe klientëve, në rastet kur klientët konsiderojnë se një gjë e tillë nuk ka ndodhur. “Në

“Sektori bankar kryefjalë e ka besueshmërinë dhe kjo ruhet nëse ofrohen shërbime të mira, por edhe nëse zgjidhen mospajtimet në mënyrë efkase dhe të shpejtë”, ka thënë drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija.



vitet e fundit, numri i klientëve të institucioneve financiare që parashtrajnë ankesë në BQK lidhur me zbatimin e të drejtave të tyre kontraktuale është rritur. Ne konsiderojmë se rritja e numrit të ankesave në mënyrë të drejtpërdrejtë reflekton vetëdijësimin më të lartë të klientëve rreth të drejtës dhe mundësisë së tyre për ankesë, gjë e cila po i kontribuon mbrojtjes më të mirë të të drejtave të tyre, por edhe po i kontribuon korrigjimit dhe avancimit të proceseve të brendshme në vetë institucionet financiare në ofrimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të shërbimeve financiare, si dhe evitimin e gabimeve të ndryshme”.

Sipas tij, ankesat e klientëve paraqesin një burim shumë të rëndësishëm informacioni edhe për BQK-në, e cila shpeshherë i merr ato në konsideratë gjatë aktiviteteve mbikëqyrëse të institucioneve financiare.

#### **MEHMETI: BQK PO PUNON NË EDUKIMIN FINANCIAR TË PUBLIKUT**

Guvernatori Mehmeti ka thënë se përveç aktiviteteve për adresimin e shkeljeve të mundshme nga institucionet financiare në raport me të drejtat e klientëve, BQK-ja po punon intenzivisht për edukimin financiar të publikut, i cili ka për qëllim që të rritë sa më tepër shkallën e njohurive të publikut rreth produkteve financiare dhe të drejtave të tyre në raport me institucionet financiare. “Përveç aktiviteteve të

saj në promovimin e edukimit financiar, BQK-ja në mënyrë të vazhdueshme inkurajon edhe vetë institucionet financiare, që të rrisin aktivitetin e tyre në mbështetje të ngritjes së njohurive të publikut rreth produkteve financiare, sepse konsumatorët e miriënformuar ndërmarrin veprime të arsyeshme dhe kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e mëtejshëm dhe ruajtjen e stabilitetit financiar”, është shprehur guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti.

#### **SHALA: MBROJTJA**

**“BQK-JA PO PUNON INTENZIVISHT NË EDUKIMIN FINANCIAR TË PUBLIKUT, I CILI KA PËR QËLLIM QË TË RRISE SA MË TEPËR SHKALLËN E NJOHURIVE TË TYRE RRETH PRODUKTEVE FINANCIARE DHE TË DREJTAVE TË TYRE NË RAPORT ME INSTITUCIONET FINANCIARE”, KA THËNË GUVERNATORI FEHMI MEHMETI.**

#### **E KONSUMATORIT, OBLIGIM I INSTITUCIONEVE**

Po ashtu, Guvernatori Mehmeti ka përmendur edhe kontributin e BQK-së për mbrojtjen e konsumatorit, si anëtare e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit, një trup ndërinstitucional që ka për qëllim të sigurojë një qasje të harmonizuar dhe gjithëpërfshirëse në sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Kosovë.

Nga ana tjetër, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala ka falënderuar Guvernatorin Mehmeti për organizimin e këtij diskutimi duke shprehur gatishmërinë që të vazhdohet edhe më tutje bashkëpunimi mes dy institucioneve në mbrojtjen e konsumatorit.

Shala ka theksuar se është obligim i institucioneve që ta mbrojnë konsumatorin. “Në

ë tregut të BE-së duhet ndërtimi i strukturës ku zbatohet ligji. Kur bëhet fjalë për sistemin financiar ne e dimë sa është e rëndësishme”, ka pohuar Shala. “Angazhimi jonë në mbrojtjen e konsumatorit është obligim i yni për zhvillimin e vendit. Ministria që unë e udhëheq është e zotuar të mbrojë të drejtat e konsumatorit”.

Përmes një prezantimi, BQK-ja ka njoftuar të pranishmit për hapat që duhet ndjekur për t’i implemtuar politikat e mbrojtjes së konsumatorit si dhe politikat që ndjek ky institucion në këtë drejtim. Në këtë diskutim është bërë prezantimi i mënyrës së shqyrtimit të ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në BQK dhe në institucionet financiare.

#### **BALJA: SEKTORI BANKAR KRYEFJALË E KA BESUESHMËRINË**

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, me këtë rast ka deklaruar se shqyrtimi i ankesave nga BQK-ja e ka lehtësuar shumë këtë çështje.

“Jam i inkurajuar nga statistikën e ankesave që i pashë. Ka pasur një fustrim nga konsumatorët që ku do të mund t’i adresonin ankesat, pasi që Gjykatat jo gjithmonë kanë qenë efikase dhe BQK-ja e ka lehtësuar shumë këtë pjesë. Në vendin tonë është shumë adekuate që BQK ta marrë përsipër këtë rol”, ka pohuar Balija.

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës ka potencuar se sektori bankar kryefjalë e ka besueshmërinë dhe kjo, sipas tij, ruhet nëse ofrohen shërbime të mira, por edhe nëse zgjidhen mospajtimet në mënyrë efikase dhe të shpejtë. “Ministria e Tregtisë ka qenë aktive në përmirësimin e rregullativës që të mos i eliminojmë ankesat e konsumatorëve, por t’i shqyrtojmë ato”, ka thënë Balija.

mënyrë që një vend si Kosova të arrij të jetë pjesë



# Depozitat arrijnë vlerën 3.36 miliardë euro

Në fund të vitit që lamë pas depozitat në sektorin bankar të Kosovës e arritën vlerën e përgjithshme prej 3.36 miliardë euro, kështu, duke shënuar rritje vjetore prej 8.7 përqind, apo 2 për qind më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak

**D**epozitat e ekonomive familjareve, por edhe të bizneseve nëpër bankat komerciale që operojnë në Kosovë gjatë vitit që lamë pas kanë pësuar rritje të konsiderueshme në raport me vitet paraprake. Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se në fund të vitit që lamë pas shuma e depozitave të qytetareve dhe bizneseve në banka ka rritur rekordin prej 3.36 miliardë euro. “Depozitat në sektorin bankar të Kosovës u rritën për 154.6 milionë euro në tremujorin e katër të vitit 2018 dhe shënuan vlerën prej 3.36 miliardë euro. Zhvillimet

në kuadër të depozitave të sektorit bankar në TM4 të vitit 2018 i atribuohen kryesisht ecurisë së depozitave për ndërmarrjet, pa anashkaluar edhe kontributin e rëndësishëm të ekonomive familjare. Depozitat e ndërmarrjeve u rritën për 104.7 milionë euro në këtë tremujor dhe arritën vlerën e përgjithshme prej 872.4 milionë euro në fund të periudhës së cekur”, thuhet në raportin e fundit të bankës Qendrore të Kosovës, të publikuar në mars të këtij viti. Në këtë raport, më tutje bëhet e ditur se depozitat për ekonomitë familjare u rritën për 58.2 milionë euro në këtë tremujor dhe arritën vlerën e

përgjithshme prej 2.33 miliardë euro.

Më tej, sipas të dhënave zyrtare të BQK-së thuhet se sipas kategorive të depozitave, depozitat e transferueshme u rritën për 84.5 milionë euro në tremujorin e katër të vitit 2018 dhe shënuan vlerën prej 2.01 miliardë euro.

Po ashtu, në këtë tremujor depozitat e afatizuara u rritën për 63.6 milionë euro dhe arritën vlerën prej 881.5 milionë euro në fund të kësaj periudhe. Përderisa, depozitat e kurtimit u rritën për 6.5 milionë euro në baza tremujore dhe arritën vlerën prej 469.1 milionë euro në fund të periudhës së cekur.

# 8.7%

është rritur shuma e depozitave në bankat komerciale në fund të vitit që lamë pas



# 2.33

miliardë euro është shuma e përgjithshme e depozitave të ekonomive familjare.

# 469.100.000€

ka arritur shuma e depozitave të kursimit në fund të vitit që lamë pas në bankat komerciale, ku vetëm gjatë tremujorit të fundit të vitit 2018 ka pasur një rritje prej 6.5 milionë euro.

# 881.500.000€

ka arritur shuma e depozitave të afatizuara nëpër bankat komerciale në Kosovë deri në fund të muajit dhjetor të vitit që lamë pas. Vetëm gjatë tremujorit të fundit të vitit 2018 depozitat e afatizuara u rritën për 63.6 milionë euro.

#### KREDITË U RRI TËN PËR 10.9%

Në fund të vitit që lamë pas, vlera e kredive nëpër bankat komerciale në vend arriti në 2.76 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 10.9 përqind. Ofertat bankare më të favorshme, të shprehura përmes përmirësimit të kushteve të kreditimit, si për ndërmarrjet edhe ekonomitë familjare, rezultuan në rritjen e gjithë stokut të kredive aktive deri në fund të periudhës së cekur. Gjithashtu, rritja e kërkesës për kredi nga të dy kategoritë, rezultoi në rritje të përgjithshme të aktivitetit kreditues përgjatë gjithë tremujorëve të vitit 2018.

Në raportin e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) thuhet se në tremujorin e fundit të vitit që lamë pas, kreditë për ndërmarrje shënuan rritje për 49.0 milionë euro,

duke arritur vlerën në 1.75 miliardë. “Në baza vjetore, në fund të tremujorit të katër të vitit që lamë pas, përjashtuar kreditimin ndaj sektorit të bujqësisë dhe atë të minierave që u karakterizuan me rënie, kreditimi ndaj të gjithë sektorëve tjerë ekonomik u karakterizua me rritje”, thuhet në raportin e BQK-së.

Më tutje në raportin e Bankës Qendrore të Kosovës thuhet se në baza tremujore, efekti i sezonalitetit dhe dinamikat me të cilët karakterizohen sektorë të ndryshëm ekonomikë rezultojnë në luhatje të mëdha nga viti në vit. Në këtë kontekst, sektori i shërbimeve tjera u rrit për 34.5 milionë euro në tremujorin e katër të vitit 2018 (rritje për 1.4 milionë euro në tremujorin e katër të vitit 2017), ndërsa sektori i tregtisë u rrit për 0.2 milionë euro, krahasuar me rritjen për 32.0 milionë euro në tremujorin e

katër të vitit 2017. “Zhvillimet në sektorët tjerë nuk rezultuan të kenë ndryshime të theksuara kundrejt tremujorit të katërt të vitit 2017. Kreditë e reja për ndërmarrje arritën vlerën në 231 milionë euro gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018, prej të cilave 152.8 milionë euro rezultuan si kredi të destinuar për investime, kurse 69.8 milionë euro për qëllime jo-investuese. Kreditë e reja për sektorin e bujqësisë në tremujorin e katër 2018 arritën vlerën në 6.5 milionë euro, një rritje prej 0.3 milionë euro kundrejt tremujorit të katërt të vitit 2017. Kreditë e reja të destinuar për industrinë u rritën për 41.2 milionë euro dhe arritën vlerën në 80.7 milionë euro në tremujorin të katërt të vitit 2018. Kurse, kreditë e reja për sektorin e shërbimeve u zvogëluan për 31.4 milionë euro, duke rënë në vlerën 107.7 milionë euro në tremujorin të

# Rëndësia e edukimit financiar

**E**dukimi financiar është duke u bërë gjithnjë e më i rëndësishëm, jo vetëm për investitorët. Është duke u bërë thelbësore për familjen mesatare që përpiqet të vendosë se si ta balancojë buxhetin e saj, të blejë një shtëpi, të financojë arsimin e fëmijëve dhe të sigurojë të ardhura kur prindërit dalin në pension.

Natyrisht, njerëzit gjithmonë kanë qenë përgjegjës për menaxhimin e financave të tyre në baza ditore, kalojnë një pushim ose kursejnë për mobile të reja, ca para ndahen mënjane për edukimin e një fëmije ose përgatitjen e tyre për jetën etj. Por, zhvillimet e fundit e kanë bërë edukimin financiar dhe vetëdijen gjithnjë e më të rëndësishme për mirëqenien financiare.

Për një gjë, sofistifikimi i tregjeve financiare nënkupton që konsumatorët nuk zgjedhin vetëm mes normave të interesit për dy kredi të ndryshme bankare, ose plane kursimi, por janë duke u ofruar shumëllojshmëri të instrumenteve financiare komplekse për huamarrjen dhe kursimin, me një gamë të gjerë opsionesh. Në të njëjtën kohë, përgjegjësia dhe rreziku për vendimet financiare që do të kenë një ndikim të madh në jetën e ardhshme të një individi, veçanërisht pensionet, po zhvendosen gjithnjë e më shumë te punëtorët dhe larg nga qeveria dhe punëdhënësit. Ndërsa rritet jetëgjatësia, çështja e pensionit është veçanërisht e rëndësishme sepse individët gëzojnë periudha më të gjata në pension.

Individët nuk do të jenë në gjendje të zgjedhin kursimet ose investimet e duhura për veten e tyre dhe mund të jenë në rrezik mashtrimi, nëse nuk janë të shkolluar financiarisht. Por, nëse individët bëhen të arsimuar financiarisht, ata do të kenë më shumë gjasa të shpëtojnë dhe të sfidojnë ofruesit e shërbimeve financiare për të zhvilluar produkte që me të vërtetë u përgjigjen nevojave të tyre dhe kjo duhet të ketë efekte pozitive në të dy nivelet e investimeve dhe në rritjen ekonomike.

Individëve gjithnjë u kërkohet të marrin përgjegjësinë e vetme dhe të marrin barrën e rrezikut për detyrat komplekse të kursimit të cilat më herët kanë qenë së paku të përbashkëta me qeveritë ose punëdhënësit, siç janë investimi për një pension ose për arsimin e lartë për fëmijët e tyre. Por si mund të pritët nga punonjës individualë ose prindër të peshojnë rreziqet dhe të bëjnë zgjedhje të përgjegjshme në një treg financiar gjithnjë e më të sofistifikuar? Kjo është e vërtetë në vendet ku

konsumatorët në përgjithësi janë të njohur me instrumentet financiare si kartat e kreditit, kreditë hipoteka-re dhe ndoshta kursimet private për të “përmirësuar” planet e pensioneve të kompanisë.

Kjo është edhe më e vështirë në ekonomitë në zhvillim, zhvillimi i shpejtë i të cilëve u ka dhënë mundësi të shërbimeve financiare një numri të madh konsumatorësh, shumë prej të cilëve kanë vetëm një përvojë të kufizuar me sistemet financiare formale. Për ekonomitë në zhvillim, konsumatorët e arsimuar financiarisht mund të ndihmojnë që sektori financiar të japë një kontribut efektiv në rritjen e vërtetë ekonomike dhe uljen e varfërisë. Por, njohuria financiare është gjithashtu vendimtare për ekonomitë më të zhvilluara, për të ndihmuar që konsumatorët të kursejnë mjaftueshëm sa duhet për të siguruar të ardhura adekuate në pension, duke shmangur nivele të larta borxhi që mund të çojnë në falimentim dhe bankrotim. Informacioni i disponueshëm për kulturën financiare të konsumatorëve është shqetësues për dy arsye: jo vetëm që individët në përgjithësi kanë mungesë të një sfondi të përshtatshëm financiar ose të kuptuarit për të lundruar në tregun kompleks të sotëm, por për fat të keq ata gjithashtu përgjithësisht besojnë se ata janë shumë më të shkolluar në aspektin financiar sesa është me të vërtetë rasti.

Kjo është bërë shkak për shqetësim në rritje për qeveritë që të ndërmarrë një numër arsyesh. Për një gjë, rritja e përdorimit të kartave të kreditit në vendet e OECD-së ka çuar në një rritje të falimentimeve personale. Në vitin 2003, pothuajse një në 10 familje amerikane paraqiti falimentim, por edhe numri i falimentimeve private në Austri u rrit me 11%. Probleme të ngjashme po shfaqen në vendet ku kredia po bëhet gjithnjë e më e përhapur. Koreja ka përjetuar rritje të mëdha në borxhin e konsumatorit, ndërsa në Gjermani ka pasur një rritje të falimentimeve private, të paktën pjesërisht për shkak të rritjes së disponueshmërisë së kredisë. Dhe për disa njerëz në vendet e OECD-së, çështja e kulturës financiare është shumë më themelore dhe bie poshtë nëse ata kanë një llogari bankare. Në të gjithë OECD-në, ndërmjet 3% dhe 10% e popullsisë janë pa llogari bankare dhe prandaj janë të izoluar financiarisht në një botë ku transaksionet financiare, përfshirë pagesën e përfitimeve të mirëqenies kryhen gjithnjë e më shumë në mënyrë elektronike.

ORGANIZATA  
PËR  
BASHKËPUNIMIN  
DHE ZHVILLIMIN  
EKONOMIK (OECD)

